

Në bazë të nenit 22-a paragrafit (2) të Ligjit për Standardin Studentor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 15/13, 120/13, 41/2014, 146/15, 30/16, 178/16, 64/18, 20/219 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.124/19, 248/20, 302/20, 235/24 dhe 111/26), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

PËR MËNYRËN E PËRCAKTIMIT TË LLOJEVE TË KONVIKTEVE STUDENTORE DHE KRITERET MË TË HOLLËSISHME PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT TË KONVIKTIT STUDENTOR

Neni 1

Me këtë rregullore konfirmohen mënyra e përcaktimit të llojeve të konvikteve studentore dhe kriteret më të hollësishme për përcaktimin e llojit të konviktit studentor.

Neni 2

Tipi 1 – konvikt studentor me efikasitet energjetik është konvikti studentor i cili i plotëson normativat dhe standardet nga neni 12 paragrafi (3) i Ligjit për Standardin Studentor, në të cilin është kryer rikonstruksion dhe i plotëson kërkesat minimale për efikasitet energjetik nga Rregullorja për karakteristikat energjetike të ndërtesave (*).

Konvikti studentor nga paragrafi 1 i këtij neni posedon Certifikatë për karakteristika energjetike, me minimum klasën B.

Neni 3

Tipi 2 – konvikt studentor ekzistues është konvikti i cili i plotëson normativat dhe standardet nga neni 12 paragrafi (3) i Ligjit për Standardin Studentor, në përputhje me Rregulloren për normativat dhe standardet për pajisjet, hapësirën dhe kuadrin në konviktet studentore.

Neni 4

Në bazë të Certifikatës për karakteristikat energjetike me minimum klasën B, të lëshuar nga bartësi i licencës për kryerjen e kontrollit energjetik të ndërtesave për konviktin e rikonstruktuar, ministri i Arsimit dhe Shkencës lëshon vërtetim për Tipin 1 – konvikt studentor me efikasitet energjetik.

Vërtetimi nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshohet për periudhë 10 vjeçare, përderisa është e vlefshme Certifikata për karakteristika energjetika me klasë minimale B.

Neni 5

Për konviktin studentor ekzistues, në të cilin nuk është kryer rikonstrukcion, ndërsa nuk i plotëson kërkesat minimale për efikasitet energjetik sipas Rregullores për karakteristikat energjetike të objekteve (*), ministri i Arsimit dhe Shkencës konviktin studentor i lëshon vërtetim për Tipin 2.

Vërtetimi nga paragrafi (1) i këtij neni ka vlefshmëri derisa konvikti studentor nuk rikonstruktohet dhe nuk merr Certifikatë për karakteristikat energjetike me klasë minimale B, të lëshuar nga bartësi i licencës për kryerjen e kontrollit energjetik të objekteve.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas sjelljes së saj.

Nr. 19-8457/1

26.6.2026

Shkup,

Министерка за образование и наука/
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска